

## ORGANET KOMPETENTE PËR REGJISTRIM TË PRONËS

Bazuar në ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, organe kompetente për regjistrimin e të drejtave pronësore janë Zyrrat Kadastrale Komunale, ndërsa Agjencia Kadastrale e Kosovës është organ i nivelit qendror i shkallës së dytë, në cilësinë e organit për ankimim.

## LLOJET E TË DREJTAVE PRONËSORE PËR REGJISTRIM

Procedurat për aplikim dhe regjistrim të të drejtave pronësore dallojnë varësisht të drejtës që regjistrohet, e ato janë si vijojnë:

- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË SHITBLERJEJE,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME AKTVENDIM TRASHËGIMIE,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË DHURIMI,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË KËMBIMI,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË SHITBLERJEJE ,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME VENDIM GJYQSORË,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME VENDIM NGA ORGANET TJERA KOMPETENTE,
- REGJISTRIM I PRONËSISË ME KREDITIM APO HIPOTEKË,
- BARTJE E PRONËSISË ME KONTRATË PËR NDËRTIM/KOMPENSIM,
- BARTJE E PRONËSISË NË BAZË TË PRANIMIT,
- REGJISTRIM I KONTRATËS ME MBAJTJE TË PËRHERSHME.

## PRONËSIA ËSHTË E DREJTA E TËRËSISHME NË NJË SEND

Pronari mund të disponojë pronën e tij sipas dëshirës së tij, nëse kjo nuk kundërshtohet nga një palë e tretë ose nga ligji.

Për bartjen e të drejtës mbi paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme e ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri. Vetëm atëherë mund ta vërtetohet pronësia me anë të certifikatës së pronësisë.

Bazuar në këtë që u tha më sipër llojet e bartjes së të drejtës së pronësisë që regjistrohen në SIKTK janë:


- BLERJA,
- TRASHËGIMIA,
- DHURIMI,
- KËMBIMI,
- NDARJA FIZIKE,
- SHPRONËSIMI,
- VENDIM GJYQËSOR,
- VENDIM NGA ORGANET KOMPETENTE,
- KREDITIM/HIPOTEKË,
- NDËRTIM/KOMPENSIM,
- NË BAZË TË PRANIMIT DHE
- MBI MBAJTJEN E PËRJETSHME.

Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Rr: "Arbnor dhe Astrit Dehari" Nr. 25  
10000  
Pristinë  
Republika e Kosovës



Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Katastarska Agencija Kosova  
Kosovo Cadastral Agency

## PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME NË KADASTËR



## REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË DHURIMI



## PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E PRONËSISË ME KONTRATË DHURIMI

Kontrata e dhurimit është akt juridik që lidhet mes dhuratëdhënësit dhe dhuratëmarrësit, mbi një pronë të paluajtshme pasi që të njëjtit kanë arritur marrëveshje për dhurimin apo faljen e saj.



Është e rëndësishme të theksohet që legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës, e njeh të drejtën e pronësisë vetëm pas ajo të regjistrohet në regjistër. Pra, pronari i ri të drejtën e tij/saj mbi pronën e paluajtshme mund ta gëzojë vetëm pas regjistrimit të saj në emrin e tij/saj në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme (RDPP).



## DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË DHURIMIT

Lidhja e kontratës së dhurimit mund të bëhet tek noteri apo në gjykatën përkatëse, bazuar në kompetencat territoriale ku ndodhet prona e paluajtshme.

Dhuratëdhënësi dhe dhuratëmarrësi duhet që ose para noterit ose në gjykatë të prezantojnë dokumentet e më poshtme:



- **DOKUMENT PËR IDENTIFIKIMIN TË DHURATË DHËNËSIT DHE DHURATË MARRËSIT APO CERTIFIKATËN E BIZNESIT PËR PERSONA JURIDIK (KOPJE),**
- **CERTIFIKATËN E PRONËSISË JO MË TË VJETËR SE GJASHTË MUAJ DHE**
- **KOPJEN E PLANIJO MË E VJETËR SE GJASHTË MUAJ.**



## DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM NË ZYRËN KADASTRALE KOMUNALE

Pas marrjes së aktvendimit tek noteri apo në gjykatë, me qëllim të ekzekutimit të tij në kadastër, pala duhet të kompletojë dokumentacionin si më poshtë:

- **KËRKESA E PALËS,**
- **NJË KOPJE TË KONTRATËS SË DHURIMI, E NOTERIZUAR,**
- **DOKUMENTET E IDENTIFIKIMIT TË TRASHËGIMTARËVE DHE CERTIFIKATËN E VDEKJES SË TRASHËGIMLËNËSIT (KOPJE),**
- **CERTIFIKATËN E PRONËSISË (KOPJE),**
- **KOPJEN E PLANIT (KOPJE),**
- **DËSHMIA E PAGESËS SË TARIFËS PËR REGJISTRIM,**
- **DOKUMENTE TJERA SHITESË (NËSE KËRKOHEN NGA ZKK, SI P.SH. TATIMI NË PRONË, ETJ).**

